



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Vau Dejes, më ____ . ____ .2023

Projekt – Propozim
Nr. 2 Date : 09/ 10/ 2023

“Për ndryshimin emërtimin te segmentit te rruges “DODAJ” , fshati Bushat , Nj.A. Bushat Bashkia Vau Dejës në rrugën, “ Gjon Ndoci” fshati Bushat, Bashkia Vau Dejes , Bashkia Vau Dejës”.

*Mbështetur në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 20, neni 23, neni 54 germa II, ligji nr 9270 date 29.07.2004 ndryshuar. Ne zbatim te urdherit te Kryetarit Nr.889 date 19.09.2023 per “Ngritjen e grupit të punes që do të proçedojë për shqyrtimin dhe trajtimin e kërkesave të banorëve që propozojnë ndryshimin/rregullimin e emertimit të segmenteve të rrugëve që janë emertuar gabim”. Si dhe nisur nga kërkesa e banorëve të lagjes përkatëse të fshatit **Bushat , Nj.A. Bushat Bashkia Vau Dejës, bashkelidhur kerkesa e banoreve.***

PROPOZOJME

- Të ndryshohet emërtimi i segmentit te rrugës:

Nr. Rruge	Emri i rruges është:	Propozohet:
03380047	Dodajve	Gjon Ndoci

- Pas Miratimit nga Këshilli Bashkiak, Vendimi do ti dërgohet Prefektit të Qarkut Shkodër.
- Ne vijim Vendimi per ndryshimin e emertimit te rruges se mesiperme do ti kaloje për zbatim nepunesit pergjgjes per sistemibn e adresave prane Bashkise Vau Dejes.

(Bashkelidhur kërkesa e banoreve, dhe harta përkatëse)

Juriste: Dorina Lekaj
Miratoi : Ana Shurdha (Drejtor)

KRYETARI
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHER
ZV/ KRYETARI
Gjovalin Zefi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Vau Dejes, më ____ . ____ . 2023

Lenda : Relacion sqarues “ Mbi ndryshimin e emertimit të një sgmenti të rrugë në fshatin Bushat, Bashkia Vau Dejes”.

Pranë Bashkise Vau Dejes, ka paraqitur kërkesen e disa banoreve të fshatit Bushat, Kryetari i fshatit Bushat, Z. Simon Dodaj, ku kanë kërkuar ndryshimin e emertimit te rruges “Dodajve” ne emertimin “ Gjon Ndoci”.

Kryetari i fshatit ka sqaruar dhe arsyet e propozimit që ka bërë lagjia për këtë ndryshim.

Sipas kryetarit te fshatit, banoret e kesaj lagje duan të respektojne emrin e z. “ Gjon Ndoci” , pasi këee emer mban dhe shkolla 9 vjeçare e fshatit Bushatit, kete arsyetim e ka paraqitur dhe me shkrim vete kryetari i fshatit ku kërkohet të behet ndryshimi i emertimit..

Rruga është nje rrugice cila nuk ka dalje, e cila rezulton e emertuar rruga e Dodajve, por sipas kryetarit te fshatit z. Simon Dodaj ky është një emertim që duhet ndryshuar dhe rruga duhet te marre emertimin “ Gjon Ndoci.

Gjithashtu sqarojme se Bashkia Vau Dejes, ka ndërhyre per ndryshim emertimi te rrugeve edhe ne raste te tjera pasi ka marre ankesa nga banore per emertime te rrugeve me emra qe banoret as nuk e dinin dhe nga vete fshati apo lagjia emërtohej me një tjetër emer.

Kjo ka ndodhur kryesisht kur Në vitin 2011 INSTAT ka realizuar Censusin e Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri , dhe në vijim kur u bë bashkimi i Sistemit të Adresave me Sistemin e Gjendjes Civile në të gjithë Republikën e Shqipërisë ka ndodhur fenomeni i mosperputhjes së adresave të banoreve me pasaportizimin e gjendjes civile, ku ka rezultuar një koplaps për gjithë adresat e banoreve të cilet jetojnë apo punojnë në një qytet tjetër apo Bashki tjetër nga ajo ku kanë Gjendjen Civile.

Duke qënë se censusi i ka gjetur në një zone të caktuar u ka dërguar automatikisht edhe adresen aty.

Të ndodhur në keto rrethana, dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr 9270 datë 29.07.2004 ndryshuar si dhe nga shkresa e Ministrisë së Brendshme Nr. 419 Prot datë 11.02.2020, ka nisur puna intensive nga Gjendja Civile si dhe nga Drejtoria e Planifikimit te Territorit ku është ngritur struktura për Menaxhimin dhe Sistemimin e Sistemit të Adresave nga ing. përkates.

Ndryshimi dhe sistemimi i adresave bëhet kur banori paraqitet në Institucion me dokument identifikimi apo pronësie, dhe gjate procedures ka rezultuar se shume lagje mbajne emertime për të cilat banoret nuk i njohin dhe nuk bien dakort, dhe kërkojne të vendosen emertimet e rrugëve siq ata i njohin prej shumë kohësh.

Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për të përligjiur proceduren dhe për të qenë sa më bashkëpunuese dhe asnjëanese me banoret ka kerkuar nga banoret që nuk bien dakort me emertimet e rrugeve dhe kërkojne ndryshimin e tyre , që procedura të kryhet me dakortesine e lagjes ku do te behet ndryshimi i rrugës dhe të kalohet për Vendim në Keshillin Bashkiak si enti pronar i cili ne zbatim te *Neni 54 Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak , germa ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkise.*

Konc. Dorina Lekaj

Adresa: “Rruga Qafa e Gurit” Vau Dejes, Telefon/Faks 00355 2612 0006 , e-mail: info@vaudejes.gov.al